



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	01.08	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Dr Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kohësia Quantity
SKM/SHK	5482/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.927/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Percuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.927/2023 të datës 06.07.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.08.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.927/2023 e datës 06.07.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile (tutje vetëm ankuesja), e punësuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, tani Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 06.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se pas përfundimit të mandatit në pozitën si zëvendësuese nga kategoria Drejtues i Ulët, e njëjta kërkon që pozita e saj të kategorizohet sipas Rregullosës QRK Nr.10/2022 për Klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sipas shtojcës Nr.2, kodit të Gr.13-Specialist i Shkencave Natyrore dhe kodit të Gr.29-Specialist i Biologjisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Mjedisit,

Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa kjo e fundit përmes shkresës së datës 18.07.2023 ka përcjell shkresat ndërlidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe se e njëjta sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit Akt Emërimit me Nr.Ref.02 të datës 13.11.2018 ushtron pozitën e punës *Zyrtare e lartë për Mbrojtje nga Ndotja dhe Aksidentet Industriale* në kuadër të Divizionit për Menaxhimin e Ndotjes Industriale. Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja në listën e pagave për muajin janar ka realizuar koeficient nëntë (7) të pagës me titull Udhëheqës i Divizionit, bazuar në Vendimin me Nr.Prot.1537/22 të datës 18.03.2022 prej nga ku ankuesja ka ushtruar pozitën si Zëvendësuese e Udhëheqësit të Divizionit për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale, ndërsa në muajin shkurt me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është klasifikuar në klasën Drejtues i Ulët.

Ankuesja me datë 06.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që pozita e saj sipas akt emërimit të përhershëm të kategorizohet sipas Rregullores QRK Nr.10/2022 për Klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil, gjegjësisht sipas shtojcës Nr.2, kodit të Gr.13-Specialist i Shkencave Natyrore dhe kodit të Gr.29-Specialist i Biologjisë.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/fit në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.




Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankueses lidhur me kategorizimin e pozitës së saj sipas Rregullores QRK Nr.10/2022 për Klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sipas shtojcës Nr.2, kodit të Gr.13-Specialist i Shkencave Natyrore dhe kodit të Gr.29-Specialist i Biologjisë është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Kolegji i Këshillit theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.927/2023

Ardita Percuku-SHYTI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

